




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 252/25-M/20
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/2
Data/Datumi/Date: 27.05.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Vërtetimi Nr. K-05/25

Datë: 27.05.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 17, 18.1., 18.2., 25 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimin Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës me datë: 27.05.2025, nxjerr këtë:

Vërtetim

Me të cilin,

- I. Konsiderohet i lejuar Përqendrimi i ndërmarrjeve, bazuar në nenin 18.1. dhe 18.2. të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Perutnina Ptuj d.o.o., mbi ndërmarrjen target UVESA.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 01.04.2025, me Nr. Prot. 154/25-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit përmes, Blerina Ramaj - Përfaqësuese Ligjore, lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Perutnina Ptuj d.o.o., mbi ndërmarrjen target UVESA. Njoftimi për Përqendrim, është i bazuar në marrëveshjen e datës, 20.03.2024, të lidhur ndërmjet palëve.

Ndërsa më 20.05.2025, Autoriteti i Konkurrencës, ka pranuar Kërkesën për nxjerrjen e Vërtetimit për Lejimin e Përqendrimit, nga ndërmarrja Perutnina Ptuj.

Vërtetimi është i bazuar në nenin 18 (Vërtetimi dhe vendimi për lejimin e përqendrimit) par. 1.1. *Përqendrimi quhet i lejuar sepse Autoriteti, mbështetur në dokumentet dhe të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi ose në njohuritë që zotëron, ka vlerësuar se përqendrimi i synuar nuk ndalohej me nenin 12 të këtij ligji dhe 1.2. nuk nxjerr konkluzion për fillimin e procedurës së vlerësimit të përqendrimit brenda tridhjetë (30) ditëve pasi pranon kërkesën e plotë për lejimin e përqendrimit.*

Poashtu, Autoriteti nuk ka pranuar komente/ankesë, nga palët e treta bazuar në njoftimin e publikuar në webfaqe, me datë: 18.04.2025. Andaj nga sa më lartë, përqendrimi është miratuar në heshtje.

Palët në Përqendrim:

Perutnina Ptuj d.o.o., është ndërmarrje e krijuar dhe e organizuar, sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë, me numër të biznesit: 5141966000, me adresë në, Potrceva cesta 10, 2250 Ptuj, Slloveni. E njëjta operon në shitjen e mishit të shpezëve dhe produkteve të mishit të tyre, kryesisht brenda tregjeve

vendase, duke shfrytëzuar kapacitetet e prodhimit personal. Shumica e produkteve të saj shpërndahen përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë distributorët, në një sërë vendesh si Kosova, Mali i Zi, Gjermania, Zvicra, Italia, Suedia, Spanja, Shqipëria, Britania e Madhe, Hungaria, Holanda, Irlanda, Sllovakia, Danimarka, SHBA dhe tregje të tjera, me shitje të herëpashershme. Perutnina është pjesë e MHP Group, një grup ndërmarrjesh kryesisht aktive në Lindjen e Mesme dhe Ukrainë. MHP qëndron si prodhuesi dhe eksportuesi më i madh i pulës në Ukrainë. Ndërmarrja e cekur më lartë, është e specializuar në rritjen e pulave, duke përfshirë kultivimin e drithërave, së bashku me aktivitete të tjera bujqësore, si prodhimi i mishit dhe produkteve të sallamit, si dhe prodhimi i produkteve të mishit të gatshëm për t'u ngrënë. Perutnina Ptuj d.o.o., dhe grupi i ndërmarrjeve të saj nuk kanë një entitet të regjistruar në Republikën e Kosovës, por janë prezent përmes shitjeve, bazuar në Marrëveshjen e Distributimit me Kosmonte Foods Sh.P.K. (blerësi).

UVESA, është ndërmarrje e krijuar dhe organizuar, e cila funksionon sipas ligjeve të Spanjës, me adresë të regjistruar në, Carretera de Zaragoza, KM 96, 2, Tudela, 31500 - Navarra (Spanjë), e inkuorporuar për një afat të pacaktuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Navarrës (Spanjë). E njëjta është një prodhues ushqimor spanjoll, kryesisht aktiv në industrinë e shpezëve, derrave dhe ushqimit të kafshëve. Më konkretisht, ndërmarrja e synuar është aktive në fushat e mëposhtme: rritjen e derrave, prodhimin dhe shpërndarjen e mishit të shpezëve, prodhimin e ushqimit të kafshëve, punën në thertore industriale të shpezëve dhe në prodhimin e mishit të përpunuar të pulës. Kjo ndërmarrje kryen vetëm biznes të kufizuar përmes shitjeve dhe ka të gjitha asetet dhe personat juridikë në Spanjë. Tutje e njëjta, nuk ka prezencë të regjistruar në Kosovë. (targeti).

Bazuar në kërkesën e paraqitësit të njoftimit për përqendrim, të datës: 20.05.2025 me Nr. Prot. 239/25-11/H, Autoriteti bazuar në nenin 18.2., lëshon këtë Vërtetim, si në dispozitiv.

AUTORITETI I KONKURENCËS



Me këtë Vërtetim, të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva